



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOZOFIK  
PRISHTINË

### RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E PROFESORËVE DHE ASISTENTËVE TË ANGAZHUAR

#### Fakulteti Filozofik

Thirrje publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime, sipas nevojave të njëjseve akademike të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/746, datë 29.05.2026.

#### Lëndët/Pozitat:

- Pozita 1. Një mësimdhënës për lëndët: Mirëqenia e fëmijëve (O), Komunikimi profesional (Z).
- Pozita 2. Një mësimdhënës për lëndët: Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Migrimi dhe kthimi (Z).
- Pozita 3. Një asistent për lëndët: Hyrje në punë sociale I (O), Hyrje në Psikologji (O), Këshillim psiko-social (O), Puna sociale me persona në konflikt me ligjin (O), Legjislacioni i punës sociale (O), Puna vullnetare (O), Kultura dhe puna sociale (Z).
- Pozita 4. Një asistent për lëndët: Hyrje në Sociologji (O), Hulumtimet kualitative (O), Mirëqenia e fëmijëve (O), Migrimi dhe kthimi (Z), Puna sociale me familje (O), Shëndeti mental në komunitet (O), Psikologji zhvillimore (Z).
- Pozita 5. Një asistent për lëndët: Shkrim akademik (Z), Gjinia dhe diversiteti (O), Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Komunikimi profesional (Z), Psikologji sociale (O), Avokimi dhe fuqizimi (Z).
- Pozita 6. Një asistent për lëndët: Filozofi e mësietës (Z), Pushteti, shteti dhe shoqëria (O), Nacionalizmi sot (Z), Marrëdhënie ndërkombëtare (O), Teoritë e kushtetutshmërisë (O), Filozofi kognitive (Z), Variacionet e barazisë dhe lirisë (Z), Filozofi e të drejtave të njeriut (Z), Filozofi e mediave (Z), (MA).
- Pozita 7. Një asistent për lëndët: Logjikë deduktive (O), Filozofi analitike (O), Filozofi e shkencës (O), Arti dhe politika (O), Temat kryesore dhe metodat në filozofi politike (O), Hyrje në teori të njohjes (O), Filozofi e logjikës (O), Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O), Filozofi e religjionit (O), Hegeli dhe filozofia e shek. 19 (Z).

Pranuar me:	18.06.2026		
Ni. oq.	Mundë	Shtopa	Vlera
03	9399	1	



Komisioni vlerësues:

1. Prof. Asoc. Njomza Lhullaku - Kryetare
2. Prof. Asoc. Violleca Krasniqi - Anëtare
3. Prof. Asst. Avdyl Gashi - Anëtar
4. Prof. Asst. Blerim Latif - Anëtar
5. Prof. Asst. Valon Leci - Anëtar

**Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave pozitive apo kandidatëve):**

**Pozita/lëndët: Pozita 1. Një mësimdhënës për lëndët: Mirëgenia e fëmijëve (O), Komunikimi profesional (Z).**

1. Bujar Thaçi
2. Adile Shaqiri
3. Aferdita Dema Tufa
4. Sedat Gushlla
5. Qëndresa Prapashtica
6. Perihane Salihu
7. Arjana Zhubi
8. Dhurata Çoçaj
9. Adnan Gajtani
10. Vlora Elshani



**Pozita/lëndët: Pozita 2. Një mësimdhënës për lëndët: Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Migrimi dhe kthimi (Z).**

1. Adile Shaqiri
2. Aferdita Dema Tufa
3. Adnan Gajtani
4. Perihane Salihu
5. Kaltrina Salihu
6. Basri Kasrati
7. Muharem Shtavica

**Pozita/lëndët: Pozita 3. Një asistent për lëndët: Hyrje në punë sociale I (O), Hyrje në Psikologji (O), Këshillim psiko-social (O), Puna sociale me persona në konflikt me ligjin (O), Legjislacioni i punës sociale (O), Puna vullnetare (O), Kultura dhe puna sociale (Z).**

- 1.Miranda Thaçi Gashi
- 2.Elifate Zeneli
- 3.Rina Kadiri
- 4.Bekrije Maxhuni
- 5.Blerta Reka
- 6.Erestina Uka
- 7.Bukurije Rrustemi Zogaj
- 8.Eliza Shporta



9. Perihane Salihu
10. Ruvejda Braha
11. Cansel Safqi
12. Arjeta Ahmedi Seferi
13. Gentiana Ferati

**Pozita/Lëndët: Pozita 4, Një asistent për lëndët: Hyrie në Sociologji (O), Hulumtimet kualitative (O), Mirëgenia e fëmijëve (O), Migrimi dhe kthimi (Z), Puna sociale me familje (O), Shëndeti mental në komunitet (O), Psikologji zhvillimore (Z).**

1. Elfate Zeneli
2. Rina Kadiri
3. Arjeta Ahmedi-Seferi
4. Bekrije Maxhuni
5. Elena Surdulli
6. Valerije Kola
7. Bukurije Rrustemi Xhemajli
8. Sebahate Shala
9. Dhurata Prokshi
10. Eliza Shporta
11. Perihane Salihu
12. Bardhyl Plakolli
13. Blerim Haliti
14. Elmaze Qerimi



**Pozita/Lëndët: Pozita 5. Një asistent për lëndët: Shkrim akademik (O), Gjinia dhe diversiteti (O), Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Komunikimi profesional (Z), Psikologji sociale (O), Avokimi dhe fuqizimi (Z).**

1. Rina Kadiri
2. Elfate Zeneli
3. Shqipdona Zogjani
4. Perihane Salihu
5. Erëza Zasella Gjoshë
6. Dhurata Çoçaj
7. Blerim Haliti
8. Bukurije Rrustemi Zogaj
9. Erestinë Uka
10. Valerije Kola
11. Labeara Selimi
12. Samir Avdiaj

**Pozita/lëndët: Pozita 6. Një asistent për lëndët: Filozofi e mësisë (Z), Pushteti, shteti dhe shogëria (O), Nacionalizmi sot (Z), Marrëdhënie ndërkombëtare (O), Teoritë e kushtetutshmerisë (O), Filozofi kognitive (Z), Variacionet e barazisë dhe lirisë (Z), Filozofi e të drejtave të njeriut (Z), Filozofi e mediave (Z), (MA).**

1. Valmir Shala
2. Elmas Haxhiraj
3. Muharem Shavica



4. Muhamet Brajsihori
5. Florida Ajazi Ramadani
6. Sedat Gushlla
7. Faruk Mustafa
8. Labeara Selimi
9. Arita Zhjegi
10. Sebahate Shala
11. Rrita Abdyli Rexha
12. Ali Nimani
13. Ridvan Emmini
14. Ibrahim Ceka
15. Perihane Salihu
16. Adnan Gajtani

**Pozita/Lëndët:** Pozita 7. Një asistent për lëndët: Logjikë deduktive (O), Filozofi analitike (O), Filozofi e shkencës (O), Arti dhe politika (O), Temat kryesore dhe metodat në filozofi politike (O), Hyrje në teori të njohjes (O), Filozofi e logjikës (O), Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O), Filozofi e religjionit (O), Hegeli dhe filozofia e shek. 19 (Z).

1. Lekë Nikollibaj
2. Arita Zhjegi
3. Rrita Abdyli - Rexha
4. Perihane Salihu



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim të profesorëve dhe asistentëve dhe asistentëve të angazhuar).*

#### **POZITA 1: Një mesimdhënës për lëndët: Mirëgenia e fëmijëve (O), Komunikimi profesional (Z).**

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni ka shqyrtuar, kontrolluar dhe vlerësuar dosjet e kandidatëve të paraqitur në thirrjen publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime, sipas nevojave të njëjësive akademike të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/746, datë 29.05.2026.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni ka konstatuar si vijon:

#### **Kandidati: Bujar Thaçi**

Kandidati Bujar Thaçi ka gradën shkencore Doktor në Punë Sociale, të fituar në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Kandidati ka të publikuara gjithsej tre (3) punime shkencore të indeksuara në Scopus, prej të cilave në dy (2) është autor i parë, ndërsa në një (1) si autor i dytë. Gjithashtu, ka marrë pjesë në konferenca shkencore rajonale dhe lokale.

Kandidati ka përvojë në mesimdhënie, duke qenë i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në Departamentin e Punës Sociale të Universitetit të Prishtinës, si dhe është Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Vlerësim të Trajtimeve në Ministrinë e Administratës Publike dhe ka thirrjen profesor asistent në Kolegjin AAB.

Bazuar në Rregulloren Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidati Bujar Thaçi i plotëson kushtet minimale për angazhim, pasi studimet e doktoratës i ka të përfunduara në fushën e Punës Sociale, e cila përputhet me profilin e kërkuar nga Departamenti i Punës Sociale. Po ashtu, kandidati plotëson kriterin minimal për publikime shkencore dhe posedon përvojë relevante në mesimdhënie.

**Rrjedhimisht, Komisioni propozon kandidatin Bujar Thaçi për angazhim si mesimdhënës i angazhuar për ligjërata në pozitën nr. 1.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### Kandidatja: Adile Shaqiri

Kandidatja Adile Shaqiri ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës, Shqipëri dhe ka gradën shkencore Doktor i Shkencave në Organizimin dhe Menaxhimin e Aktiviteteve Sociale, të fituar në Universitetin Jug-Perëndimor “Neofit Rilskî”, Blagoevgrad, Bullgari.

Kandidatja ka të publikuar një (1) publikim si autore e parë në një revistë të indeksuar në Scopus, si dhe publikime të tjera (si autore e parë, dytë) në revista shkencore ndërkombëtare. Po ashtu, kandidatja ka pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ka përvijë profesionale në fushën e punës sociale, në shërbime sociale dhe në proceset e politikëbërjes sociale.

Bazuar në Rregulloren Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Adile Shaqiri i plotëson kushtet minimale për angazhim, duke pasur studimet Bachelor dhe Master në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës dhe studimet e doktoratës në fushë të përafërt me profilin e Punës Sociale. Gjithashtu, kandidatja plotëson kriteret lidhur me publikimet shkencore dhe ka përvijë profesionale relevante në fushën përkatëse.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve të paraqitur për këtë pozitë, Komisioni, në diskrecionin e tij ka propozuar për pozitën nr. 1 kandidatin paraprak. **Ndërkaq, kandidatja Adile Shaqiri propozohet për angazhim në pozitën nr. 2 të kësaj thirrje publike ku ka aplikuar poashtu.**

### Kandidatja: Afërdita Dema Tufa

Kandidatja Afërdita Dema Tufa ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në fushën e Psikologjisë. Kandidatja nuk ka publikime shkencore, i cili është një nga kushtet minimale të përcaktuara me Rregulloren Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale për angazhim në këtë pozitë, për shkak të mungesës së publikimeve shkencore si dhe në krahasin me kandidatin e propozuar, profili akademik i kandidatës nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Afërdita Dema Tufa për angazhim në këtë pozitë.**

### Kandidati: Sedat Gushlla

Kandidati Sedat Gushlla ka të përfunduara studimet në të tri nivelet akademike (Bachelor, Master dhe Doktoratë) në fushën e Diplomacisë. Kandidati ka dy (2) publikime në revista ndërkombëtare, por të cilat nuk janë të profilit të punës sociale.



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidatin e propozuar, profili akademik dhe publikimet shkencore të kandidatit nuk përputhen me fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatin Sedat Gushlla për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Qendresa Prapashtica**

Kandidatja Qendresa Prapashtica ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në fushën e Psikologjisë. Kandidatja ka një (1) publikim shkencor në një revistë ndërkombëtare si autore e shtatë. Në dosjen e aplikimit nuk është dorëzuar diploma për nivelin Bachelor që pamundëson verifikimin e notës mesatare për kandidatët me gradë Master (neni 7, fushnotë 1).

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka sjellur dokumentacionin e plotë, si dhe fusha e studimeve në krahasim me kandidatin e propozuar nuk është në Punë Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Qendresa Prapashtica për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Perihane Salihu**

Kandidatja Perihane Salihu ka të përfunduara studimet Bachelor në Pedagogji të Përgjithshme dhe studimet Master në Psikologji. Kandidatja nuk ka publikime shkencore, i cili është një nga kushtet minimale të përcaktuara me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale për angazhim në këtë pozitë për shkak të mungesës së publikimeve shkencore si dhe në krahasim me kandidatin e propozuar, asnjë nivel i studimeve i kandidatës nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Perihane Salihu për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

---

### **Kandidatja: Arjana Zhubi**

Kandidatja Arjana Zhubi ka gradën shkencore Doktor i Shkencave në Edukim (Mësimdhënia dhe të Mësuarit), nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. Kandidatja ka dy (2) publikime shkencore në fushën e edukimit të indeksuara në Scopus, në të cilat është autore e parë.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidatën e propozuar, profili akademik dhe publikimet shkencore të kandidatës nuk përputhen me fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Arjana Zhubi për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Dhurata Çoçaj**

Kandidatja Dhurata Çoçaj ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Në dosjen e aplikimit nuk janë dorëzuar diploma apo transkriptat e notave për nivelin Bachelor dhe Master.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale për angazhim në këtë pozitë. Për më tepër, profili akademik i kandidatës nuk përputhet me fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Dhurata Çoçaj për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidati: Adnan Gajtani**

Kandidati Adnan Gajtani posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave në Qeverisje dhe Administratë Publike, nga South East European University – Tetovë, Maqedonia e Veriut. Kandidati ka një (1) publikim shkencor të indeksuar në Scopus, i cili nuk është i profilit të punës sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidatën e propozuar, profili akademik dhe publikimi shkencore të kandidatit nuk përputhen me fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Adnan Gajtani për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### **Kandidatja: Vlora Elshani**

Kandidatja Vlora Elshani ka gradën shkencore Doktor i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Menaxhim Konfliktesh, të fituar në Universitetin "Ss. Cyril and Methodius". Kandidatja ka dy (2) publikime shkencore në revista rajonale (Magedoni).

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidatin e propozuar, profili akademik i kandidatës nuk përputhen me fushën e Punës Sociale. **Rrijedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Vlora Elshani për angazhim në këtë pozitë.**

### **POZITA 2. Në mësimdhënës për lëndët: Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Migrimi dhe kthimi (Z).**

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni ka shqyrtuar, kontrolluar dhe vlerësuar dosjet e kandidatëve të paraqitur në thirrjen publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime, sipas nevojave të njëjste akademike të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/746, datë 29.05.2026.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni ka konstatuar si vijon:

#### **Kandidatja: Adile Shaqiri**

Kandidatja Adile Shaqiri ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës, Shqipëri dhe ka gradën shkencore Doktor i Shkencave në Organizimin dhe Menaxhimin e Aktiviteteve Sociale, të fituar në Universitetin Jug-Perëndimor "Neofit Riliski", Blagoevgrad, Bullgari.

Kandidatja ka të publikuar një (1) publikim si autore e parë në një revistë të indeksuar në Scopus, si dhe publikime të tjera (si autore e parë, dytë) në revista shkencore ndërkombëtare. Po ashtu, kandidatja ka pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ka përvojë profesionale në fushën e punës sociale, në shtëpime sociale dhe në proceset e politikëbërjes sociale.

Bazuar në Rregulloren Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Adile Shaqiri i plotëson kushtet minimale për angazhim, duke pasur studimet Bachelor dhe Master në Punë Sociale nga Universiteti i Tiranës dhe studimet e doktoratës në fushë të përfaqërt me profilin e Punës Sociale. Gjithashtu, kandidatja plotëson kriteret lidhur me publikimet shkencore dhe ka përvojë profesionale relevante në fushën përkatëse.



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni propozon kandidatën Adile Shaqiri për angazhim si mësimdhënësi i angazhuar për ligjërata në pozitën nr. 2.

### **Kandidatja: Afërdita Dema Tufa**

Kandidatja Afërdita Dema Tufa ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në fushën e Psikologjisë. Kandidatja nuk ka publikime shkencore, i cili është një nga kushtet minimale të përcaktuara me Rregulloren Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale për angazhim në këtë pozitë, për shkak të mungesës së publikimeve shkencore si dhe në krahasim me kandidatën e propozuar, profili akademik i kandidatës nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Afërdita Dema Tufa për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidati: Adnan Gajtani**

Kandidati Adnan Gajtani posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave në Qeverisje dhe Administratë Publike, nga South East European University – Tetovë, Maqedonia e Veriut. Kandidati ka një (1) publikim shkencor të indeksuar në Scopus, i cili nuk është i profilit të punës sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidatën e propozuar, profili akademik dhe publikimi shkencore të kandidatit nuk përputhen me fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Adnan Gajtani për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Perihane Salihu**

Kandidatja Perihane Salihu ka të përfunduara studimet Bachelor në Pedagogji të Përgjithshme dhe studimet Master në Psikologji. Kandidatja nuk ka publikime shkencore, i cili është një nga kushtet minimale të përcaktuara me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale për angazhim në këtë pozitë për shkak të mungesës së publikimeve shkencore si dhe në krahasim me kandidatën e propozuar, asnjë nivel i studimeve i kandidatës nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Perihane Salihu për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### Kandidatja: Kaltrina Salihu

Kandidatja Kaltrina Salihu ka gradën shkencore Doktor i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Menaxhim të Konfliktit, nga Universiteti "Shën Kiriil dhe Metodi", Shkup, Maqedonia e Veriut. Studimet Master i ka përfunduar në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë, ndërsa studimet Bachelor në Sociologji. Kandidatja ka 1 publikim shkencor në Revistë Ndërkombëtare dhe 1 publikim në Revistë Rajonale (Maqedoni).

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidaten e propozuar, asnjë nivel i studimeve i kandidatës nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrijdhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Kaltrina Salihu për angazhim në këtë pozitë.**

### Kandidati: Basri Kastrati

Kandidati Basri Kastrati ka gradën shkencore Doktor i Shkencave Juridike, të ftuar në Universitetin e Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut. Kandidati ka edhe 2 publikime shkencore në revistë rajonale (Maqedoni), dhe jo të profilit të punës sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidaten e propozuar, asnjë nivel i studimeve i kandidatit nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrijdhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatin Basri Kastrati për angazhim në këtë pozitë.**

### Kandidati: Muharem Shtavica

Kandidati Muharem Shtavica posedon gradën shkencore Doktor i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, nga Akdeniz University, Turqi. Kandidati ka 1 publikim shkencor, por jo të profilit të punës sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se në krahasim me kandidaten e propozuar, profili akademik i kandidatit nuk është në fushën e Punës Sociale. **Rrijdhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatin Muharem Shtavica për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

**POZITA 3: Një asistent për lëndët: Hyrie në punë sociale (O), Hyrie në Psikologji (O), Këshillim psiko-social (O), Puna sociale me persona në konflikt me ligjin (O), Legjislacioni i punës sociale (O), Puna vullnetare (O), Kultura dhe puna sociale (Z).**

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni ka shqyrtuar, kontrolluar dhe vlerësuar dosjet e kandidatëve të paraqitur në thirrjen publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime, sipas nevojave të njëjësive akademike të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/746, datë 29.05.2026.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni ka konstatuar si vijon:

### **Kandidatja: Miranda Thaçi Gashi**

Kandidatja Miranda Thaçi Gashi ka të përfunduara studimet Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe studimet Master në Psikologji Organizative dhe Sociale në Kolegjin AAB – Prishtinë. Kandidatja ka notën mesatare në studimet Bachelor 9.67 dhe notën mesatare në studimet Master 9.83, në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara me rregullore.

Kandidatja ka përvojë profesionale në Qendren për Punë Sociale dhe aktualisht është e angazhuar si psikologe shkollore. Komisioni vlerëson se kjo përvojë paraqet një aset të vlefshëm për zhvillimin dhe realizimin e ushtrimeve, duke ofruar njohuri praktike dhe kompetenca profesionale që janë në përputhje me profilin e lëndëve të shpallura në fushën e Punës Sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja i plotëson kushtet minimale për angazhim, pasi ka përfunduar studimet në nivelin Bachelor në Punë Sociale, plotëson kriterin e notës mesatare dhe ka përvojë relevante në fushën përkatëse.

**Rijedhimisht, Komisioni e propozon kandidaten Miranda Thaçi Gashi për angazhim si asistent i angazhuar për ushtrime në pozitën nr. 3.**

### **Kandidatja: Elfate Zeneli**

Kandidatja Elfate Zeneli ka të përfunduara studimet e nivelit Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa studimet Master i ka të përfunduara në Shkencën e Edukimit dhe Këshillimit Pedagogjik në Universitetin e



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Prishtinës “Hasan Prishtina”. Kandidatja ka notën mesatare në studimet Bachelor 8.93 dhe notën mesatare në studimet Master 8.19, në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara me rregullore.

Kandidatja ka një (1) vit përvojë pune/angazhimi në Qendër për Punë Sociale, përvojë e cila nga komisioni vlerësohet si aset i vlefshëm për zhvillimin dhe realizimin e ushtrimeve dhe e përshatshme për profilin e lëndëve të shpallura Punës Sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Elfate Zeneli i plotëson kushtet minimale për angazhim, pasi ka përfunduar studimet e nivelit Bachelor në Punë Sociale, plotëson kriterin e notës mesatare dhe ka përvojë relevante në fushën përkatëse.

**Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve të paragjitur për këtë pozitë, Komisioni, në diskrecionin e tij ka propozuar për pozitën nr. 3 kandidaten paraprake. Ndërkaq, kandidatja Elfate Zeneli propozohet për angazhim në pozitën nr. 4 ku ka aplikuar poashtu.**

**Kandidatja: Rina Kadiri**

Kandidatja Rina Kadiri ka të përfunduara studimet Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe studimet Master në “Master i Shkencave në Punë Sociale: Drejtimi Politikë Sociale” në Universitetin e Tiranës. Kandidatja ka notën mesatare në studimet Bachelor 9.77 dhe notën mesatare në studimet Master 9.82, në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara për angazhimin e asistentëve të angazhuar.

Kandidatja ka përvojë profesionale dhe angazhim në fushën e të drejtave të njeriut dhe punës sociale. Gjithashtu, kandidatja ka kontribuar përmes angazhimit në përgatitjen e një raporti mbi drejtësinë tranzicionale gjithëpërfshirëse për të rinjtë, të cilin komisioni e vlerëson si element shtesë relevant për profilin e saj profesional dhe akademik.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Rina Kadiri i plotëson kushtet minimale për angazhim pasi ka përfunduar studimet e dy nivele në Punë Sociale dhe plotëson kriterin e notës mesatare.

**Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve të paragjitur për këtë pozitë, Komisioni, në diskrecionin e tij ka propozuar për pozitën nr. 3 kandidaten znj. Thaçi Gashi. Ndërkaq, kandidatja Rina Kadiri propozohet për angazhim në pozitën nr. 5 ku ka aplikuar poashtu.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### Kandidatja: Bekrije Maxhuni

Kandidatja Bekrije Maxhuni ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", si dhe studimet Master në Psikologji – Programi Klinik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Kandidatja është kandidatë e studimeve të doktoratës në Psikologji Organizative dhe e Punës në Universitetin "Kliment Ohridski", Sofje – Bullgari.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrijedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Bekrije Maxhuni për angazhim në këtë pozitë.**

### Kandidatja: Blerta Reka

Kandidatja Blerta Reka ka të përfunduara studimet bachelor në Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale në Kolegjin Dardania, Prishtinë, si dhe studimet master në Psikologji Klinike në Kolegjin Heimerer, Prishtinë. Në dosjen e saj, kandidatja nuk ka dorëzuar diplomën e studimeve bachelor dhe as transkriptat e notave, dokumente të domosdosime sipas kërkesave të thirrjes publike.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk e ka sjellur dosjen e plotësuar sipas kriterëve obligative të thirrjes publike si dhe nuk ka asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrijedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Blerta Reka për angazhim në këtë pozitë.**

### Kandidatja: Erestina Uka

Kandidatja Erestina Uka ka të përfunduara studimet Bachelor në Logopedi në Kolegjin Heimerer, Prishtinë, si dhe në Psikologji në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Kandidatja ka studimet Master në "Master Shkencor në Psikologji dhe Neuroshkencë të Shëndetit Mendor" në King's College London, si dhe "Master i Shkencave në Logopedi" në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu, në CV figuron si kandidatë e studimeve të doktoratës në Shkencat të Edukimit – Edukim Gjithpërfshirës, në bashkëpunim ndërmjet Universitetit të Ljubljanes dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për të cilën nuk është bashkëngjitur dokumentacion mbështetës/dëshmi në dosjen e aplikimit.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahësim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Erestina Uka për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Bukurije Rrustemi Zogaj**

Kandidatja Bukurije Rrustemi Zogaj ka të përfunduara studimet Bachelor në Sociologji dhe Gazetari në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe studimet Master në Sociologji në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Master në Marrëdhënie me Publikun dhe Publicitet në Universitetin Ege, Turqi.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahësim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Bukurije Rrustemi Zogaj për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Eliza Shporta**

Kandidatja Eliza Shporta ka të përfunduara studimet Bachelor dhe Master në Psikologji në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahësim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Eliza Shporta për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Perihane Salihu**

Kandidatja Perihane Salihu ka të përfunduara studimet Bachelor në Pedagogji të Përgjithshme në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe studimet Master në Psikologji Organizative dhe Sociale në Kolegjin AAB.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahësim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Perihane Salihu për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### **Kandidatja: Ruvejda Braha**

Kandidatja Ruvejda Braha ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji në Universitetin e Tetovës, si dhe studimet Master në Psikologji Klinike në të njëjtin universitet. Në CV figuron si kandidat e studimeve të doktoratës në Psikologji Klinike në International Balkan University, Shkup, Maqedonia e Veriut.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Ruvejda Braha për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Cansel Safqi**

Kandidatja Cansel Safqi ka të përfunduara studimet Bachelor në fushën e Zhvillimit të Fëmijëve në Hacettepe University, Turqi, si dhe studimet Master në Edukim – Arsim Special në Gazi University, Turqi.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Arjeta Ahmedi Seferi**

Kandidatja Arjeta Ahmedi-Seferi ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji dhe studimet Master në Psikologji Klinike dhe Shëndet. Gjithashtu, në CV figuron si kandidat e studimeve të doktoratës në Psikologji Klinike në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” (UKIM), Shkup, Maqedonia e Veriut, për të cilën nuk është bashkëngjitur dokumentacion mbështetës/dëshmi në dosjen e aplikimit.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Arjeta Ahmedi-Seferi për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### **Kandidatja: Gentiana Ferati**

Kandidatja Gentiana Ferati ka të përfunduar studimet Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa është në proces të përfundimit të studimeve Master në Punë Sociale në Universitetin e Tiranës.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se, për shkak të mos përfundimit të studimeve Master, kandidatja nuk i plotëson kushtet minimale të përcaktuara për angazhim në këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Gentiana Ferati për angazhim në këtë pozitë.**

**POZITA 4: Një asistent për lëndët: Hvrje në Sociologji (O), Hulumtimet kualitative (O), Mirëqenia e fëmijëve (O), Migrimi dhe kthimi (Z), Puna sociale me familje (O), Shëndeti mental në komunitet (O), Psikologji zhvillimore (Z).**

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni ka shqyrtuar, kontrolluar dhe vlerësuar dosjet e kandidatëve të paraqitur në thirrjen publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime, sipas nevojave të njëjrive akademike të Universitetit të Prishtinës, Nr. Prot. 1/746, datë 29.05.2026.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni ka konstatuar si vijon:

### **Kandidatja: Elfate Zeneli**

Kandidatja Elfate Zeneli ka të përfunduar studimet e nivelit Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërsa studimet Master i ka të përfunduar në Shkencat e Edukimit dhe Këshillimit Pedagogjik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Kandidatja ka notën mesatare në studimet Bachelor 8.93 dhe notën mesatare në studimet Master 8.19, në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara me rregulloren.

Kandidatja ka një (1) vit përvojë pune/angazhimin në Qendër për Punë Sociale, përvojë e cila nga komisioni vlerësohet si aset i vlefshëm për zhvillimin dhe realizimin e ushtrimeve dhe e përshtatshme për profilin e lëndëve të shpallura Punës Sociale.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Elfate Zeneli i plotëson kushtet minimale për angazhim, pasi ka përfunduar studimet e nivelit Bachelor në Punë Sociale, plotëson kriterin e notës mesatare dhe ka përvojë relevante në fushën përkatëse.



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

**Rrjedhimisht, Komisioni propozon kandidaten Elfate Zeneli për angazhim si asistente e angazhuar për ushtrime në pozitën nr. 4.**

**Kandidatja: Rina Kadiri**

Kandidatja Rina Kadiri ka të përfunduara studimet Bachelor në Punë Sociale në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, si dhe studimet Master në “Master i Shkencave në Punë Sociale: Drejtimi Politikë Sociale” në Universitetin e Tiranës. Kandidatja ka notën mesatare në studimet Bachelor 9.77 dhe notën mesatare në studimet Master 9.82, në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara për angazhimin e asistentëve të angazhuar.

Kandidatja ka përvojë profesionale dhe angazhim në fushën e të drejtave të njeriut dhe punës sociale. Gjithashtu, kandidatja ka kontribuar përmes angazhimit në përgatitjen e një raporti mbi drejtësinë tranzicionale gjithëpërfshirëse për të rinjtë, të cilin komisioni e vlerëson si element shtesë relevant për profilin e saj profesional dhe akademik.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja Rina Kadiri i plotëson kushtet minimale për angazhim pasi ka përfunduar studimet e dy nivele në Punë Sociale dhe plotëson kriterin e notës mesatare.

**Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve të paraqitur për këtë pozitë, Komisioni, në diskrecionin e tij ka propozuar kandidaten paraprake për pozitën nr. 4. Ndërkaq, kandidatja Rina Kadiri propozohet për angazhim në pozitën nr. 5 ku ka aplikuar poashtu.**

**Kandidatja: Arjeta Ahmedi-Seferi**

Kandidatja Arjeta Ahmedi-Seferi ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji dhe studimet Master në Psikologji Klinike dhe Shëndet. Gjithashtu, në CV figuron si kandidat e studimeve të doktoratës në Psikologji Klinike në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” (UKIM), Shkup, Magedonia e Veriut, për të cilën nuk është bashkëngjitur dokumentacion mbështetës/dëshmi në dosjen e aplikimit.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidaten e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidaten Arjeta Ahmedi-Seferi për angazhim në këtë pozitë.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### **Kandidatja: Bekrije Maxhuni**

Kandidatja Bekrije Maxhuni ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", si dhe studimet Master në Psikologji – Programi Klinik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Kandidatja është kandidatë e studimeve të doktoratës në Psikologji Organizative dhe e Punës në Universitetin "Kliment Ohridski", Sofje – Bullgari.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidatën e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Bekrije Maxhuni për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Elena Surdulli**

Kandidatja Elena Surdulli ka të përfunduara studimet Bachelor në Logopedi në Kolegjin Heimerer dhe studimet Master në Punë Sociale në Universitetin e Pécs-it-Hungari. Kandidatja nuk ka dorëzuar dëshmi për nostrifikimin e diplomës së fituar jashtë vendit, dokument i domosdoshëm sipas kërkesave të konkursit.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk e ka sjellur dosjen e plotësuar sipas kriterëve obligativë të thirrjes publike. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Elena Surdulli për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Valerije Kola**

Kandidatja Valerije Kola ka të përfunduara studimet Bachelor në Edukim dhe studimet Master në Edukim – Këshillim Pedagogjik.

Bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Nr. Prot. 2/254, datë 17.07.2024, Komisioni vlerëson se kandidatja nuk ka profilin akademik në drejtimin e Punës Sociale duke mos pasur asnjë nivel të studimit në fushën e punës sociale, në krahasim me kandidatën e propozuar për këtë pozitë. **Rrjedhimisht, Komisioni nuk e propozon kandidatën Valerije Kola për angazhim në këtë pozitë.**

### **Kandidatja: Bukurije Rrustemi Zogaj**

